

**VENDIM**  
**Nr.71, datë 3.2.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, për njësitë e qeverisjes qendrore, është 576 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përjashtimisht, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2010, për njësitë e qeverisjes qendrore, ndërsa për ALUIZNI-n, të përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit.

4. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë me hollësi numrin e punonjësve, sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, brenda kriterëve të vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

| Gr. | Emri i Institucionit                                       | Nr. punonjësve | Emërtesa                            | Koha mesatare   | Muajt   |
|-----|------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------|-----------------|---------|
| 04  | Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës           | 19             |                                     |                 |         |
|     | Aparati i ministrisë                                       | 1              | Sanitare                            | deri 3 orë/ditë | vjetor  |
|     | Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit                  | 1              | Operatore                           | deri 5 orë/ditë | vjetor  |
|     | Inspektoriati Qendror Teknik                               | 1              | Sanitare                            | deri 3 orë/ditë | vjetor  |
|     | Inspektoriati Qendror Teknik                               | 1              | Punëtor mirëmbajtjeje në laboratorë | deri 5 orë/ditë | vjetor  |
|     | ALBINVEST                                                  | 1              | Sanitar                             | deri 3 orë/ditë | vjetor  |
|     | Shërbimi Gjeologjik                                        | 2              | Punëtor shpimi                      | 3-5 orë/ditë    | vjetor  |
|     | Shërbimi Gjeologjik                                        | 1              | Punëtor rievimi                     | 3-5 orë/ditë    | vjetor  |
|     | Shërbimi Gjeologjik                                        | 11             | Nëpunës roje                        | 8 orë/ditë      | 5 muaj  |
| 06  | Ministria e Punëve Publike, Transportit Telekomunikacionit | 500            |                                     |                 |         |
|     | ALUIZNI                                                    | 500            | Specialistë/ndihmës specialistë     | 8 orë/ditë      | 10 muaj |
| 10  | Ministria e Financave                                      | 18             |                                     |                 |         |
|     | Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve                     | 4              | Specialiste                         | 8 orë/ditë      | 6 muaj  |

|    |                                                                                                    |     |                      |                 |         |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|----------------------|-----------------|---------|
|    | Sektori i pagesave të dëmshtëpërblimeve                                                            | 1   | Punonjës arkive      | 8 orë/ditë      | 6 muaj  |
|    | Drejt. Financimeve, Kontraktimeve/dega e thesarit Tiranë                                           | 1   | Roje                 | 8 orë/ditë      | 6 muaj  |
|    | Drejtoria e Përgj.Financimeve dhe Kontraktimeve                                                    | 1   | Sanitare             | deri 3 orë/ditë | vjetore |
|    | Degët e thesarit                                                                                   | 7   | Sanitare             | deri 3 orë/ditë | vjetore |
|    | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve                                                                | 4   | Operatore            | deri 4 orë/ditë | vjetore |
| 16 | Ministria e Brendshme                                                                              | 3   |                      |                 |         |
|    | Aparati                                                                                            | 1   | Specialist përkthyes | 8 orë/ditë      | 6 muaj  |
|    |                                                                                                    | 2   | Teknikë              | 8 orë/ditë      | 6 muaj  |
| 25 | Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale                                                            | 35  |                      |                 |         |
|    | Aparati                                                                                            | 4   | Roje                 | 8 orë/ditë      | 4 muaj  |
|    | Në institucionet e shtëpisë së foshnjës/ moshuarve/qendrat e zhvillimit/qendrat pritëse dhe ditore | 21  | Mjekë                | deri 4 orë/ditë | vjetore |
|    |                                                                                                    | 10  | Sanitar              | deri 4 orë/ditë | vjetore |
| 77 | Autoriteti i Konkurrencës                                                                          | 1   |                      |                 |         |
|    | Autoriteti i Konkurrencës                                                                          | 1   | Teknik mirëmbajtje   | 6 orë/ditë      | 12 muaj |
|    | Total numri i punonjësve                                                                           | 576 |                      |                 |         |